



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1102/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi, kryesues, Milena Djerić dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Jehonë Mehmetukaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1102/2021 i datës 04.11.2021, i parashtruar nga Jehonë Mehmetukaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar të rinumërohen votat në Vendvotimin: 0601C/03R.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1102/2021 (përmes postës më datë 04.11.2021), nga Jehonë Mehmetukaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me nr.24, dega në Istog, me të cilin pretendon se në Vendvotimin 0601C/03R, e kanë votuar pesë anëtarë të familjes Beqiraj, ndërsa numri i votave në këtë VV i ka dalur 0.

Kërkon nga PZAP-i të rinumëroj votat në VV0601C/03R

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Jehonë Mehmetukaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Armërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog është i pabazuar pasi që Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidaten në fjalë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1102/2021 më datën 09.11.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.